



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 5702

NR. VENDIMI 6348

V E N D I M
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

ANTONELA PRENDI - GJYQTARE

asistuar nga sekretarja gjyqësore Dila Doçi, sot më datë **18.07.2016** perfundoi gjykimin në seancë gjyqësore publike te ceshtjes civile nr 5702 Akti,që i përket:

PADITESA : Shoqeria tregtare “ *** “ sh.a, me seli ne ***, me filial ne ***, me administrator z. ***, perfaqesuar nga av. *** ne baze te prokures se posacme nr ***,dt ***,

Shoqeria “***, me seli ne ***, perfaqesuar nga z. *** dhe av. *** ne baze te prokures se posacme nr ***,dt ***.

E PADITUR : Shoqeria “ *** “ sh.p.k, me qender ne ***, perfaqesuar nga av. *** ne baze te prokures se posacme nr ***,dt ***.

PERSON I TRETE : Drejtoria e Pergjithshme e Markave dhe Patentave, perfaqesuar nga juristja *** ne baze te autorizimit dt 27.06.2016.

OBJEKTI : Deklarim i paligjshem i aktivitetit tregetar te importit dhe qarkullimit ne tregun shqiptar te produktit piceta higjenike “Evvy Days” per shkak se perben nje aktivitet qe perfshihet ne konkurrencen e padrejte cenimin e markes tregtare “Every Day”.

Ndalimi i te paditurit te importoje dhe te shperndaje ne tregun shqiptar produktin piceta higjenike “Evvy Days” si dhe cdo produkt tjeter qe mbart imitime te markes tregtare dhe dizenjove te produktit “Every Day”.

Bllokimi dhe shkaterrimi me shpenzimet e te paditurit te gjithë produkteve piceta higjenike “Evvy Days” te importuara dhe te shperndara ne tregun shqiptar me shumice dhe me pakice nga i padituri si dhe kudo qe mund te gjenden prane nje subjekti tregëtar ose magazine ose cdo vend tjetër ne RSH.

Bllokimi (sekuestrimi) i cdo dokumenti ose fature e te paditurit qe kane te bejne me importimin dhe qarkullimin e produktit piceta higjenike Evvy Days.

Detyrimin e te paditurit te paguaje shpenzimet gjyqesore duke perfshire pagesat e kryera nga paditesi per sherbimet juridike te avokatise.

BAZA LIGJORE : Nenet 608-644 te Kodit Civil. Ligji nr 9947,dt 07.07.2008 “Per pronesine industriale”. Nenet 31,32,153-156 te KPrC.

Gjykata pasi mori ne shqyrtim marreveshjen e paleve ndërgjyqese per zgjidhjen me pajtim te ketij konflikti gjyqesor

VE REN

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte paraqitur per gjykim kerkesepadia me pale ndërgjyqese, objekt dhe baze ligjore te sipercituar.

Pas zhvillimit te nje hetimi te plote dhe te gjithanshem te ceshtjes, administrimit te provave dhe debatit te tyre ne perputhje me parimin e kontradiktoritetit rezultoi e provuar :

Paditesi “***” eshte shoqeri tregëtare greke e cila ka rregjistruar prane Drejtorise se Pergjithshme te Markave dhe Patentave prej dt 15.02.2005 marken “ EVERY DAY” ,qe i perket produktit “piceta higjenike”, fakt i konfirmuar nga certifikata per perteritjen e rregjistrimit te markes e administruar ne cilesine e proves ne gjykim.

Me dt 01.06.2015 shoqeria“***” ka lidhur me paditesin tjetër te ketij gjykimi shoqerine “ *** “ sh.a kontraten per distribucionin e produktit piceta higjenike “EVERY DAY” ne territorin e RSH ne respektim te te drejtave dhe detyrimeve te percaktuara ne permbajtje te kontrates.

Paditesat kane ardhur ne dijeni te faktit se i padituri shoqeria “ *** “ sh.p.k ka importuar nga subjekti ***, me qender ne ***, artikuj te llojit “piceta higjenike “ me emertimin “EVVY DAY”. Sipas shkreses nr *** Prot,dt 08.01.2016 Drejtoria e Pergjithshme e Doganave konfirmon se produkti piceta higjenike “ EVVY DAY” eshte importuar nga shoqeria “ *** “ sh.p.k nga nje subjekt tregëtar me qender ne *** (***). Keto te dhena gjejne

pasqyrim dhe ne deklaraten doganore te administruar ne gjykim. Ndersa Drejtoria e Pergjithshme e Markave dhe Patentave ne vertetimin nr *** prot,dt 13.01.2016 parashtron se nuk rezulton te jete rregjistruar apo te jete depozituar per rregjistrim marka “EVVY DAY”.

Produktet e importuara nga pala e paditur pretendohet se perbejne imitim te markes te rregjistruar nga pala paditese referuar elementeve te jashtem individualizues:

- produktet kane madhesi dhe forem te njejte. Ne te dy artikujt dominojne ngjyrat blu dhe roze dhe mbishkrimi ne qender te konfeksionit, ne shiritin roze “Hyperdry”;

- cdo mbishkrim qe eshte i njejte per te dy produktet ka te njejtin stil shkronjash, madhesi dhe ngjyre;

- mbishkrimet ne produktin kopjues jane te gjitha si ne produktin origjinal. Produkti original identifikon artikullin piceta higjenike “EVERY DAY” ndersa produkti qe pretendohet se perben cenim te markes identifikohet me shenimin “EVVY DAYS”. Stili i njejte i shkrimit, afersia e shkronjave, ngjyrat e njejta dhe emertimi gati i njejte i produktit krijojne veshtiresi ne dallimin dhe diferencimin mes tyre;

- ne fund te produktit origjinal shkruhet “Super plus” i shoqeruar nga simboli i pikave te ujit, te cilat gjenden dhe ne produktin qe pretendohet se perben cenim te markes tregetare te rregjistruar nga pala kerkuese;

- produktet i perkasin te njejtës klase “piceta higjenike “ sipas klasifikimit te katalogut te Nices.

Te gjithë elementet e mesiperme qe individualizojne produktin origjinal permes markes, te rregjistruar dhe mbrojtur ne baze te legjislacionit ne fushen e pronesise industriale, sipas pretendimit te paditesave, krijojne konfuzion te dukshem ne radhet e konsumatoreve, te cilet riskohen te konfundojne produktin origjinal, nga ai qe mbart marken e imituar. Ky konstatim ne raport me produktin e importuar dhe tregetuar ne kushtet e cenimit te markes tregetare, demton interesat e paditesave qe prodhojne dhe shperndajne te njejtin artikull ne territorin e RSH, mbi bazen e nje marke te rregjistruar.

Per keto arsye paditesat “*** “ sh.a dhe “*** i jane drejtuar gjykates me ane te padise objekt gjykimi duke kerkuar ndalimin e te paditurit shoqeria *** sh.p.k per te importuar dhe tregetuar produktin piceta higjenike Evvy Days ne territorin e RSH si dhe bllokimin e shkaterrimin e sasise se ketyre produkteve te importuara qe perbejne cenim te markes se rregjistruar Every Day dhe dokumentacionit shoqerues te tij.

Pala e paditur parashtroi gjate gjykimit se nuk ka qene ne dijeni te faktit se produktet e importuara prej saj piceta higjenike Evvy Days perben imitim te markes se rregjistruar nga pala paditese “***, per te cilen gezonte ekskluzivitetin e tregetimit ne territorin e RSH shoqeria “***sh.a.

Ne kushtet e mesipeme palet kerkuan zgjidhjen me pajtim te konfliktit gjyqesore duke i paraqitur per miratim gjykates akt marreveshjen e arritur mes tyre si me poshte vijon :

1.pala e paditur deklaron dhe eshte dakort se nuk do te prodhoje, importoje, qarkulloje dhe nuk do te shperndaje ne tregun shqiptar, produktin peceta higjenike Evvy Days.

2.pala e paditur *** sh.p.k heq dore nga aplikimi i markes Evvy Days ne Drejtorine e Markave dhe Patentave dhe nuk do te kerkoje aplikimin e kesaj marke me emrin Evvy Days.

3.pala e paditur deklaron dhe garanton palen paditese se nuk ka prodhim piceta higjenike Evvy Days, as etiketa dhe ambalazh me prodhimin Evvy Days ne ambientet e saj dhe ne treg dhe ne asnje vend tjeter dhe ne rast se gjendet eshte dakort per shkaterrimin e tyre.

4.pala paditese deklaron se ne keto kushte heq dore nga gjykimi i padise si dhe persa i perket detyrimit te te paditurit per pagimin e te gjitha shpenzimeve gjyqesore, duke perfshire pagesat e kryera nga paditesi per sherbimet juridike dhe te avokateve.

Gjykata ne shqyrtim te kerkeses se paleve ndergjyqese per zgjidhjen me pajtim te mosmarreveshjes mori ne analize nenin 158/b te KPrC, i cili sanksionon:

" Gjyqtari gjate veprimeve perгатitore ben te gjitha perpjekjet per te zgjidhur mosmarreveshjen me pajtim kur e lejon natyra e ceshtjes. Per kete qellim kur eshte rasti urdheron dhe paraqitjen e vet paleve.

Perpjekjet per pajtim mund te perseriten ne cdo faze te hetimit gjyqesor.

Kur arrihet pajtimi pa filluar séanca gjyqesore mbahet procesverbal i cili nenshkruhet nga palet. Gjyqtari me vendim miraton pajtimin.

Kur pajtimi arrihet ne séance gjyqesore kushtet e marreveshjes pasqyrohen ne procesverbalin gjyqesor. Gjykata jep vendim per miratimin e tij , por ne cdo rast ai nuk duhet te jete ne kundershtrim me ligjin.

Kunder vendimit per zgjidhjen e mosmarreveshjes me pajtim ose mospranimin e pajtimit mund te behet ankim i vecante "

Gjykata cmon se zgjidhja me pajtim e mosmarreveshjes civile qe eshte bere objekt shqyrtimi gjyqesor synon te rregulloje pasojat e marredhenies juridike mes paleve ndergjyqese sipas vullnetit reciprok te tyre, te materializuar ne marreveshjen e pajtimit dhe te miratuar nga gjykata, e cila mbikqyr ligjshmerise se saj.

Pajtimi mund te realizohet ne cdo faze te hetimit gjyqesor nga vete palet ndergjyqese te pranishme ne gjykim ose perfaqesuesit e tyre, te cilet duhet te disponojne shprehimisht nga te perfaqesuarit tagrin e zgjidhjes me pajtim te konfliktit gjyqesor referuar nenit 97/2 te KPrC.

Ne procesin e zgjidhjes me pajtim te mosmarreveshjes, e cila shmang

shqyrtimin gjyqesor te konfliktit dhe vazhdimin e metejshe me te veprimeve procedurale, gjykata ushtron kontrollin e ligjshmerise se marreveshjes te arritur mes paleve ndergjyqese, qe nenkupton verifikimin e perputhjes se saj me dispozitat kushtetuese, ligjore e nenligjore, duke konkluduar miratimin e pajtimit ose refuzimin e tij ne rast paligjshmerie.

Miratimi gjyqesisht i pajtimit permes vendimit gjyqesor i jep fuqi detyruese marreveshjes se arritur mes paleve dhe fuqi ekzekutuese ne raport me pasojat e mosmarreveshjes civile, te rregulluara vullnetarisht prej tyre.

Gjykata ne veshtrim te nenit 158/b te KPrC cmon se marreveshja e arritur mes paleve per zgjidhjen me pajtim te konfliktit gjyqesor, sipas kushteve te referuara ne permbajte te akt marreveshjes nuk vjen ne kundërshtim me ligjin, por garanton respektimin e dispozitave materiale ligjore qe synojne mbrojtjen e te drejtave pasurore dhe jopasurore te subjekteve qe jane pronare te nje marke te rregjistruar. Marreveshja e arritur mes paleve perkon me frymen e parimeve ligjore mbi ndalimin e perdorimit te nje marke te rregjistruar nga nje subjekt i trete, permes huazimit te elementeve identifikues, te njejte ose te ngjashem, duke krijuar konfuzion ne treg mes produkteve, me pasoja jo vetem per subjektin qe gezon mbrojtjen ligjore te markes, por dhe konsumatoreve:

Neni 156 i ligjit nr 9947, dt 07.07.2008 “Per pronesine industriale “ sanksionon:

Te drejtat qe rrjedhin nga rregjistrimi :

1.Pronari i markes se rregjistruar gezon te drejten ekskluzive te perdorimit te markes ne perputhje me te drejtat e parashikuara ne kete ligj.

2.Pronari i markes se rregjistruar gezon te drejten te ndaloje pesonat e trete te perdorim gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre tregtare pa autorizimin e tij :

a) nje shenje qe eshte e njejte me marken, per mallra dhe sherbime, qe jane te njejta me ato per te cilat eshte rregjistruar marka;

b) nje shenje qe eshte e njejte ose e ngjashme me marken apo qe per shkak te njellojshmerise apo ngjashmerise se mallrave ose sherbimeve , per te cilat perdoret shenja me mallra ose sherbime qe perdoren nga marka e rregjistruar, mund te shkaktojne konfuzion te publiku, ku perfshihet dhe mundesia e bashkelidhjes se shenjes me marken tregtare;

c) nje shenje te njejte ose te ngjashme per mallra ose sherbime, edhe kur keto nuk jane as te njejta dhe as identike me ato, per te cilat eshte rregjistruar marka ne rast se marka ka reputacion ne RSH dhe nga perdorimi i shenjes pa shkak te arsyeshem realizohet nje perfitim i padrejte ose demtohet natyra dalluese apo emri i mire i markes.

3.Ne perputhje me piken 2 te ketij neni gjithashtu ndalohet :

a) vendosja e shenjes te mallrat apo ambalazhet e tyre;

b)hedhja e mallrave ne treg, ofrimi i tyre per shitje, duke perdorur kete shenje ose krijimi e mbajtja e rezervave per kete qellim;

c)importimi ose eksportimi duke perdorur kete shenje;

d) perdorimi i shenjes ne veprimtarine tregtare, ne reklamime ose

publicitete....”

Marreveshja e arritur mes paleve rivendos te drejtat jopasurore te cenuara te pales paditese dhe garanton mosperseritjen ne te ardhmen te ketij cenimi permes marrjes se masave te dakortesuara mes ndergjyqesave. Kushtet e marreveshjes se paraqitur per miratim ne gjykim sigurojne se pari ndalimin e tregtimit te produktit Evvry Days ne imitim te markes tregtare Every Day, shkaterrimin e sasise se produkteve ekzistuese dhe dokumentacionit shoqerues te tyre, ndalimin e importimit apo prodhimit ne te ardhmen te produktit ne kushtet e imitimit te markes dhe heqjen dore nga rregjistrimi i markes imituese Evvry Days prane Drejtorise se Pergjithshme te Markave dhe Patentave.

Sa me siper gjykata konkludon se marreveshja e arritur mes paleve jo vetem nuk kontestohet nga kuadri ligjor qe mbron produktet e pronesise industriale, por siguron dhe mbrojtjen e te drejtave jopasurore te pales paditese qe pranohet nga i padituri te jene cenuar ne kushtet e importimit e tregtimit te te njejtit lloj produkti nen emertimin e nje marke te ngjashme me ate te rregjistruar nga paditesi. Marreveshja eshte nenshkruar perpara gjykates nga perfaqesuesit respektiv te paleve ndergjyqese, prej te cileve i padituri gezonte shprehimisht tagrat e zgjidhjes me pajtim te konfliktit ne aktin e perfaqesimit. Kjo marreveshje gjeti aprovimin edhe te personit te trete Drejtoria e Pergjithshme te Markave dhe Patentave, e cila shprehu pelqimin per miratimin e saj.

Persa i takon shpenzimeve gjyqesore palet kane rene dakort ne akt marreveshje qe taksa gjyqesore dhe shpenzimet e perfaqesimit te mbeten ne ngarkim te seciles pale qe i ka realizuar ato.

Per kete arsye gjykata ne baze te nenit 158/b te KPrC dhe ligjit “ Per pronesine industriale “ vendos te miratoje akt marreveshjen dt 18.07.2016 te nenshkruar mes paditesit dhe pales se paditur per zgjidhjen me pajtim te ketij konflikti gjyqesore sipas kushteve te dakortesuara mes tyre te sipercituara ne vendimin gjyqesor.

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar në nenet 158/b, 306, 309 të K. Pr. Civile dhe ligjit “ Per pronesine industriale “ gjykata

VENDOSI

1.Miratimin e zgjidhjes me pajtim te ceshtjes civile nr 5702 Akti, me pale paditese shoqeria tregtare “*** “sh.a dhe “***, pale e paditur shoqeria tregtare *** sh.p.k dhe person i trete Drejtoria e Pergjithshme e Markave dhe Patentave sipas akt marreveshjes se nenshkruar mes paleve dt 18.07.2016 :

-pala e paditur deklaroi dhe eshte dakort se nuk do te prodhoje, importoje,

qarkulloje dhe nuk do te shperndaje ne tregun shqiptar, produktin peceta higjenike Evvy Days.

-pala e paditur *** sh.p.k heq dore nga aplikimi i markes Evvy Days ne Drejtorine e Markave dhe Patentave dhe nuk do te kerkoje aplikimin e kesaj marke me emrin Evvy Days.

-pala e paditur deklaroi dhe garantoi palen paditese se nuk ka prodhim piceta higjenike Evvy Days, as etiketa dhe ambalazh me prodhimin Evvy Days ne ambientet e saj dhe ne treg dhe ne asnje vend tjeter dhe ne rast se gjendet eshte dakort per shkaterrimin e tyre.

-pala paditese deklaroi se ne keto kushte heq dore nga gjykimi i paditese si dhe persa i perket detyrimit te te paditurit per pagimin e te gjitha shpenzimeve gjyqesore, duke perfshire pagesat e kryera nga paditese per sherbimet juridike dhe te avokateve.

3.Nje kopje e akt marreveshjes dt 18.07.2016 i bashkangjitet vendimit gjyqesor.

4.Leshimin e urdherit te ekzekutimit per kete vendim gjyqesor.

5. Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.

6.Kunder ketij vendimi lejohet ankimi ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 5 diteve nga e nesermja e shpalljes se vendimit.

U shpall sot më datë 18. 07. 2016 në Tirane.

**SEKRETARE
GJYQTARE**

**DILA
ANTONELA PRENDI**

DOÇI

SHPENZIME GJYQESORE

Takse gjyqesore *** leke

Shpenzime njoftimi *** leke